



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM NR 88 Datë 24.12.2021

Për dhenje "Qytetar Nderi "


Mbështetur në Ligjin nr.139, datë 17.12.2015“Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 54, germa m, me kerkese nga Drejtoria e Pergjithshme e Policise se Shtetit dega Diber Nr. 3118 prot date 24.09.2021 dhe me relacionin e komisionit te perhershem te keshillit Bashkiak me date 03.12.2021 : **Komisioni I rendit publik, mbrojtjes civile dhe vlersimit të figurave të shquara të qytetit** ;i paraqet Këshillit Bashkiak ne rendin e dites në mbledhjen e rradhës miratimin per **dhenje "Qytetar Nderi "** per te ndjerin **Z. Arsen Mersim Iskurti** . Keshilli ne mbledhjen e tij, datë 24.12.2021 miratoi unanimisht .

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin për **dhenje "Qytetar Nderi "** per te ndjerin **Z. Arsen Mersim Iskurti**.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori I arsimit dhe Kultures dhe Turizmit .
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Kryetar, Këshilli
Sokol Sava





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
SINDIKATA E PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT
DEGA DIBËR

Peshkopi, më 08.09.2021

Lënda : **PROPOZIM PËR DHËNIEN E TITULLIT "QYTETAR NDERI" (PAS VDEKJES) TË NJË ISH PUNONJËSI TË POLICISË KOMISAR ARSEN MERSIM ISKURTI**

**BASHKISË DIBËR
KËSHILLIT BASHKIAK**

PESHKOPI

Në referim të parashikimeve të neneve 15 dhe 16 të ligjit 112/2013, "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", Sindikata e punonjësve të Policisë së Shtetit, Dega Dibër, në vlerësim të kontributit të dhënë ndër vite në strukturat e Policisë së Shtetit, të ish punonjësit të ndjerë Komisar Arsen Mersim Iskurti në drejtim të luftës ndaj krimit dhe ruajtjes së rendit e qetësisë publike, nëpërmjet këtij propozimi, synojmë që Këshilli Bashkiak, Bashkia Dibër, t'i japë titullin: "Qytetar Nderi", (pas vdekjes), me motivacionin: "Për merita të veçanta, profesionalizëm dhe rezultate të larta në punë, për përkushtimin e treguar në përmbushjen e detyrave dhe kontributin e dhënë në shërbim të Policisë së Shtetit".

Ka patur një karrierë prej 22 vitesh në strukturat e Policisë së Shtetit, në detyra të ndryshme, si: Komandant toge në Repartin e Rendit, Komisariati i Policisë Mat, komandant i PKK Bllatë, shef i Zyres në Luftën Kundër Drogës, specialist në Seksionin e Antiterrorit, shef Seksioni Kundër Trafikeve të Paligjshme, në Drejtorinë Vendore të Policisë Dibër. Nga data 05.03.2016 deri më 16.09.2020, ka kryer detyrën: Shef seksioni/specialist, në Seksionin e Teknologjisë dhe Përgjimit, në Drejtorinë Vendore të Policisë Dibër.

Me datë 16.09.2020 ka ndërruar jetë, shkak i vdekjes, "I.A.M".

Gjatë gjithë karrierës së tij, në strukturat e Policisë së Shtetit, ka punuar me ndershmëri, korrektësi, devotshmëri, profesionalizëm, integritet e standarde të larta etike dhe përkushtim për kryerjen të gjithë detyrave të ngarkuara.

Ka patur rezultate të larta në zbulimin, parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale

dhe sigurimin e rendit e qetësisë publike. Treguesit e punës së tij kanë qenë të qëndrueshme dhe kanë ardhur vazhdimisht në rritje. Ka udhëhequr gjithmonë me shembullin personal dhe ka qenë burim frymëzimi për të tjerët.

Në të tilla rrethana, duke mbajtur në konsideratë faktin se ish punonjësi i policisë, i ndjeri Komisar Arsen Iskurti, nuk është dënuar asnjëherë për shkelje të rënda të ligjit, si dhe kontributin e madh të dhënë në parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale dhe sigurimin e rendit e qetësisë publike, për 22 vite me radhë gjatë kohës që ka shërbyer në strukturat e Policisë së Shtetit, vlerësojmë se ish punonjësi policisë përmbush kriteret për dhënien e titullit: "Qytetar Nderi" (pas vdekjes).

Ju bëjmë me dije dhe shpresojmë që nëse do të vlerësohet e motivuar dhe në përmbushje të kriterëve ligjore, të bëhet mundësisht me procedurë të shpejtuar, dhënia e titullit: "Qytetar Nderi" dhe të jepet në datën 16.09.2021, datë e cila përkon me një vjetorin e ndarjes nga jeta të të ndjerit.

Duke besuar dhe shpresuar në mirëkuptimin Tuaj!

Shefi Sektorit Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve
Kryekomisar Agim ROBI



Kryetari i Sindikatës
Nënkomisar Rasik KRRASHI

